

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, si procesmbajtëse, në lëndën penale të pandehurit M.K., nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit të pandehurit, av.I.H., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.22/2017, të dt.27.02.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 05.09.2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit M.K., av.I.H. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.22/2017, të dt.27.02.2017, vërtetohet.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.22/2017, të dt.27.02.2017, i pandehuri M.K. është shpallur fajtor për veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400(katërqind)Euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.19.01.2017, gjerë me dt.27.02.2017.

I pandehuri, nëse dënimin me gjobë nuk e paguan në afatin e caktuar, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim e në atë mënyrë për çdo 20Euro të dënimit me gjobë të i caktohet një 1(ditë)burgim.

I pandehuri është obliguar që asaj gjykate t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të asaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij, aktgjykimi ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të pandehurit M.K., av.I.H., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë dhe burg më të butë ose dënimin e shqiptuar me burgim t'ia zëvendësoj me dënim me gjobë, ose t'ia shqiptoj dënimin me kusht e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.179/2017, të datës 05.04.2017, duke u sqaruar përkritazi me ankesat e mbrojtësit të pandehurit, ka propozuar që

ankesa e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë i pandehuri M.K., dhe mbrojtësi i tij, av.l.H., ndërsa ka munguar Prokurori i Apelit- DKR në Prishtinë edhe pse ishte njoftuar në mënyrë të rregullt e seanca e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.4 të KPP, është mbajtur në mungesë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, e sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve ankimore, në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të pandehurit, si dhe të sqarimit me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas vlerësimit edhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të pandehurit M.K., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë, nga ana e mbrojtësit të pandehurit M.K., e sipas detyrës zyrtare e në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 384 par.1 dhe 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të pandehurit dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurit në ankesën e tij, pretendon se i pandehuri M.K., ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, se është3 penduar për veprën penale të kryer dhe në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme dhe në kuadër të këtyre rrethanave gjykata a të gjej që të pandehurit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata e Apelit, vlerëson, se pretendimet e paraqitura ankimore të mbrojtësit të pandehurit, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e të pandehurit, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale dhe të gjitha këto rrethana janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e të cilat janë të pranueshme dhe dënim i shqiptuar me gjobë në shumë prej 400(katërqind)Euro dhe me burgim prej 6(gjashtë)muajve, është nën minimumin e paraparë ligjor, për arsye se për këto vepra penale minimumi ligjor është dënimi me burgim prej 3(tri)viteve ndërsa maksimumi ligjo është dënim ime burgim deri në 12(dymbëdhjetë)vite, duke marrë parasysh se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK, gjykata ia ka zbutur dënimin nën minimumin e paraparë ligjor të cekur më lartë për arsye se me rastin e pranimit të fajësisë, me rastin e zbutjes së dënitimit, gjykata nuk detyrohet nga kufizimet e parapara në nenin 76 të KPRK, ku dënimi mund të zbutet deri në 1(një)vit burgim. Në kuadër të këtyre dispozitave ligjore duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të pandehurit, në mungesë të ankesës së PTH-DKR në Ferizaj, Gjykata e Apelit, vlerëson se dënimi i shqiptuar është në përpjesëtim të plotë me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe në tërësi pritët të arrihet qëllimi i dënitimit që i pandehuri të M.K., në të ardhmen të mos kryej vepra të tilla penale dhe të bëhet rehabilitimi i tij, si dhe të parandaloj edhe të tjerëve në kryerjen e veprave penale, dhe me këtë do të arrihet edhe qëllimi i dënitimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e mbrojtësit të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar e në bazë të nenit 401 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.176/2017, me dt.05.09.2017**

**Procesmbajtësja,**

\_\_\_\_\_  
**Arta Dumani**

**Anëtarët e Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Fillim Skoro**

\_\_\_\_\_  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Vahid Halili**